





Pranimat / Dorezuar Prilapeno / Prilapato Received / Delivery	27.05	2022	2	viti and year
Organ / Njësia Org / Unit	No Prot to Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHOCK	3135/2022		1/13	

## Republika e Kosovës

### Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

## RAPORTI I MONITORIMIT TË JASITËZAKONSHËM

*në*

Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, si dhe Agjencinë  
Kadastrale të Kosovës

Prishtinë, maj 2022



## TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje .....	3 fq
Baza Ligjore.....	4 fq
Gjendja e Fakteve.....	8-9 fq
Konstatimet.....	10-12 fq
Rekomandimet.....	13 fq

## HYRJE

Këshilli, gjatë implementimit të mandatit të tij lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, bënë monitorim të jashtëzakonshëm në rastet kur Këshilli konsideron së janë bërë shkelje të legjislacionit të shërbimit civil. Në këtë rast, nëntë (9) nga nëpunësit civilë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

dhe \_\_\_\_\_ më datë 25.01.2022 kanë parashtruar kërkesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për monitorim të jashtëzakonshëm lidhur me emërimin dhe mbajtjen e pozitave për Zëvendësues të Drejtorit të Departamentit dhe Zëvendësues i Udhëheqësit të Divizionit pranë kësaj ministrie.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mbledhjen e datës 08.02.2022 ka aprovuar kërkesën e palëve me Vendimin me Nr.03/2022 dhe ka emëruar Kolegjin për Monitorim të Jashtëzakonshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Kolegji i caktuar për monitorim të jashtëzakonshëm me datë 12.02.2022 ka njoftuar Zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm për vizitën monitoruese në këtë institucion me datë 15.02.2022. Po me datë 15.02.2022, nga menaxherja e personelit \_\_\_\_\_ jemi udhëzuar që zëvendësuesit i referohen pjesës së planifikimit dhe mjedisit andaj edhe është propozuar zonja \_\_\_\_\_ si pikë kontakti.

Kolegji rikujton se me Vendimin Nr.07-V-005 të datës 03.02.2020 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës është bërë riorganizimi i ministrive ashtu që është bërë bashkim i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor tani me emërtimin Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizim ky i përcaktuar edhe me Rregulloren (QRK) – Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.



## BAZA LIGJORE PËR MONITORIM TË JASHTËZAKONSHËM

Këshilli funksionin e monitorimit jashtëzakonshëm e ushtron mbi bazën e autorizimit ligjor të përcaktuar me nenin 20 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.48/2018 për Monitorimin e Institucioneve të Administratës Publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit të Shërbimit Civil.

Sipas nenit 20 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil: *Këshilli, me qëllim të vlerësimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka të drejtë që për çdo vit të monitorojë institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil. 2. Funksionin e monitorimit, Këshilli e ushtron përmes monitorimit të rregullt që realizohet sipas planit vjetor të monitorimit, dhe përmes monitorimit të jashtëzakonshëm që realizohet në raste të veçanta që ndërlidhen me shkelje të rënda të legjislacionit për shërbimin civil. 3. Anëtari i Këshillit është i obliguar që të paraqet raportin me të gjetura dhe rekomandime në mbledhjen e Këshillit dhe të jep sqarime për të gjitha çështjet e ngritura nga Këshilli. 4. Këshilli, pas shqyrtimit të raportit nxjerr vendim, të cilin së bashku me raportin ia dërgon institucionit përkatës. 5. Institucioni përkatës i administratës publike është i obliguar për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit, brenda afatit të përcaktuar me vendimin e Këshillit.*

Neni 6 i Rregullores Nr.48/2018 për Monitorimin e Institucioneve të Administratës Publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit të Shërbimit Civil përcakton: *1. Monitorimi i jashtëzakonshëm realizohet në raste të veçanta që ndërlidhen me shkelje të rënda të legjislacionit të shërbimit civil nga institucionet e administratës publike..... 3. kërkesë për monitorim të jashtëzakonshëm ka të drejtë të parashtrij: 3.1. Kryetari apo anëtari i Këshillit; 3.2 Zyrtari Kryesor Administrativ i Institucionit Përkatës; 3.3 Së paku pesë (5) nëpunës civil të institucionit përkatës; 3.4 Institucionet kompetente për zbatim të ligjit dhe 3.5 Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës...*

## RAPORT PËR MONITORIMIN E JASHTËZAKONSHËM

Këshilli, gjatë procesit të monitorimit të jashtëzakonshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për të vlerësuar drejtë dhe saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga kjo ministri lidhur me caktimin e zëvendësuesve në pozitat e Udhëheqësit të Divizionit dhe Udhëheqësit të Departamentit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit dhe Infrastrukturës, si mostra ka marre dokumentet si në vijim:

- Listën me emrat e nëpunësve të cilët mbajnë pozita si zëvendësues në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për vitet 2020 dhe 2021.
- Vendimin me numër protokollit 4589/21 të datës 26.10.2021 lidhur me caktimin e nëpunëses L. L si zëvendësueses në pozitën Kryeshefit Ekzekutiv për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.
- Vendimin me numër protokollit 4882/21 të datës 07.06.2021 lidhur me caktimin e nëpunësit I. B si zëvendësueses në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Vendimin me numër protokollit 5086/21 të datës 10.11.2021 lidhur me caktimin e nëpunësit A. Sh si zëvendësueses në pozitën e Udhëheqësit të Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës/AMMK-MMPHI, së bashku me akt emërimin e datës 01.01.2015.
- Vendimin me numër protokollit 5864/21 të datës 24.12.2021 lidhur me caktimin e nëpunëses H.ZH si zëvendësueses në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave në MMPHI, së bashku me akt emërimin e datës 15.05.2014.
- Vendimin me numër protokollit 125/22 të datës 12.01.2022 lidhur me caktimin e nëpunësit E.Sh si zëvendësueses në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Inspektim të Mbrojtjes së Mjedisit në MMPHI, së bashku me akt emërimin e datës 10.02.2014.
- Vendimin me numër protokollit 5467/21 të datës 02.12.2021 lidhur me caktimin e nëpunësit N.A si zëvendësueses në pozitën e Drejtorit të Autoritetit Rajonal të Pëllgjeve Lumore në MMPHI.
- Vendimin me numër protokollit 3358 të datës 19.04.2021 lidhur me caktimin e nëpunësit N.A si zëvendësueses në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Pagesa Ujore dhe Projekte në MMPHI, së bashku me akt emërimin e datës 01.07.2015.
- Vendimin me numër protokollit 4176/21 të datës 01.10.2021 lidhur me caktimin e nëpunëses L.S si zëvendësueses në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Kimikate dhe Mbeturina në MMPHI, së bashku me e-mailin e datës 14.09.2021 dhe akt emërimin e datës 01.05.2013.
- Vendimin me numër protokollit 5401-2/19 të datës 18.03.2021 lidhur me caktimin e nëpunëses V.I si zëvendësueses në pozitën e Udhëheqësit në Divizionin për Mbrojtjen nga Ndotja



Industriale, së bashku me vendimin numër 5401/19 të datës 02.09.2019 lidhur me caktimin si zëvendësueses në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale dhe akt emërimin e datës 13.11.2018.

- Vendimin me numër protokolli 2531/21 të datës 07.12.2021 lidhur me shfuqizimin e Vendimit me numër Nr.2531/21 të datës 25.06.2021 për nëpunësin B.T si zëvendësues në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Menaxhimin e Resurseve Ujore si dhe e-mailat zyrtar të datës 25.06.2021.
- Vendimin me numër protokolli 1022/21 të datës 12.03.2021 lidhur me caktimin e nëpunësit A.A si zëvendësueses në pozitën e Drejtorit të Drejtorisë për Administrimin e Monumenteve Natyrore me Rëndësi të Veçantë së bashku me Vendimin me numër 2750/21 të datës 24.08.2021 lidhur me vazhdimin e mandatit si zëvendësues për këtë pozitë; Kërkesën e datës 24.08.2020 nga nëpunësi A.A për lirim nga detyra e zëvendësuesit; Vendimin me numër 2750/21 të datës 12.07.2021 lidhur me vazhdimin e mandatit si zëvendësues për këtë pozitë në MMPHI.
- Vendimin me numër protokolli 6912/19 të datës 25.11.2019 lidhur me caktimin e nëpunësit A.S si zëvendësueses në pozitën e Drejtorit të Drejtorisë për Administrimin e Monumenteve Natyrore me Rëndësi të Veçantë së bashku me Vendimin me numër 2242/20 të datës 04.05.2020 lidhur me vazhdimin e mandatit në këtë pozitë në MMPHI
- E-mailin zyrtar të datës 15.02.2022 lidhur me dërgimin e listës së pagave për periudhën prej muajit dhjetor të vitit 2021 deri në muajin janar të vitit 2022 për nëpunësit të cilët mbajnë pozita të zëvendësuesve në MMPHI, si dhe e-mailin zyrtar të datës 15.02.2022 në MMPHI.
- Lista me nëpunësit në pozitat e zëvendësuesve në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, përmes e-mailit zyrtar të datës 16.02.2022.
- Vendimin me numër protokolli 01/1033/21 të datës 09.06.2021 lidhur me caktimin e nëpunësit N.M zëvendësueses në pozitën e Drejtorit të Drejtoratit të Teknologjisë Informativë, së bashku me akt emërimin e datës 11.01.2012.
- Vendimin me numër protokolli 01/3641/20 të datës 01.12.2020 lidhur me caktimin e nëpunësit N. Sh si zëvendësueses në pozitën e Udhëheqësit të Sektorit të Hartimit dhe Harmonizimit të Legjislacioni, së bashku me ndryshim plotësimin e akt emërimit të datës 29.01.2019;
- Vendimin me numër protokolli 01/1938/18 të datës 16.08.2018 lidhur me caktimin e nëpunësit K. A si zëvendësueses në pozitën e Drejtorit në Drejtoratin e Regjistrimit mbi Pronat e Paluajtshme në AKK, së bashku me akt emërimin e datës 01.10.2014.
- Vendimin me numër protokolli 01/3640/20 të datës 01.12.2020 lidhur me caktimin e nëpunësit B.SH si zëvendësueses në pozitën e Drejtorit në Drejtoratin Ligjor në AKK, së bashku me akt emërimin e datës 12.06.2015.

- Vendimin me numër protokolli 2131 të datës 03.06.2021 lidhur me caktimin e nëpunëses A.H si zëvendësueses në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm në AKK, së bashku me akt emërimit e datës 11.01.2012
- Vendimin me numër protokolli 148 të datës 12.01.2022 lidhur me caktimin e nëpunësit në pozitën Zyrtar kryesor financiar, së bashku me akt emërimit e datës 16.12.2013.
- Raportin e prezencës në punë për nëpunësen A.Th për periudhën nga data 01.09.2019-30.09.2019, 01.10.2019-31.10.2019.



## GJENDJA E FAKTEVE:

Kolegji i Këshillit gjatë monitorimit të jashtëzakonshëm në këtë institucion, duke u bazuar në deklaratën e Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore si dhe mostrave të siguruar ka konstatuar se:

- Në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës janë tetë (8) pozita me zëvendësues si vijon:
  1. Sipas Vendimit me numër protokollit 4589/21 të datës 26.10.2021 të Ministrit të MMPHI-së, nëpunësja L.L nga pozita e Udhëheqëses së Institutit Hidrometeorologji të Kosovës, është caktuar zëvendësuese e Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës;
  2. Sipas Vendimit me numër protokollit 4882 të datës 07.06.2021 të Ministrit të MMPHI-së, nëpunësi civil I.B është caktuar zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Mjedisit.
  3. Sipas Vendimit me numër protokollit 5086/21 të datës 10.11.2021 të zëvendësuesit të Kryeshefes Ekzekutive të AMMK-së, nëpunësi A.Sh nga pozita e Udhëheqësit të Sektorit për Monitorimin e Cilësisë së Ujit dhe Dheut në Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës, është caktuar zëvendësues i Udhëheqësit të Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës.
  4. Sipas Vendimit me numër protokollit 5864/21 të datës 24.12.2021 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, nëpunësja H.ZH nga pozita e Udhëheqëses së Divizionit për Koordinim të Politikave është caktuar zëvendësuese e Drejtorit të Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave.
  5. Sipas Vendimit me numër protokollit 125/22 të datës 12.01.2022 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, nëpunësi E.SH nga pozita e Inspektorit për Mbrojtjen e Ujërave, është caktuar zëvendësues i Udhëheqësit të Divizionit për Inspektim të Mbrojtjes së Mjedisit, Natyrës dhe Ujërave.
  6. Sipas Vendimit me numër protokollit 5467/21 të datës 02.12.2021 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, nëpunësi N.A në pozitën e zëvendësuesit të Udhëheqësit të Divizionit për Pagesa Ujore dhe Projekte, është caktuar si zëvendësues në pozitën e Drejtorit të Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore.
  7. Sipas Vendimit me numër protokollit 4176 të datës 01.10.202 zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së nëpunësja L.S nga pozita Zyrtare e Lartë për Menaxhimin e Mbeturinave të Rrezikshme është caktuar zëvendësuese e Udhëheqësit të Divizionit për Kimikate dhe Mbeturina.

8. Sipas Vendimit me numër protokolli 5401-2/19 të datës 18.03.2021 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, nëpunësja V.I nga pozita e ushtrueses së detyrës së Udhëheqëses së Divizionit për Mbrojtjen nga ndotja Industriale është caktuar në pozitën zëvendësuese e Udhëheqësit në Divizionin për mbrojtjen nga ndotja industriale.
- Në Agjencinë Kadastrale të Kosovës janë pesë (5) pozita me zëvendësues si vijon:
1. Sipas Vendimit me numër protokolli 01/1033/21 të datës 09.06.2021 të zëvendësueses së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kadastrale, nëpunësi N.M, nga pozita Administrator i Aplikacioneve të IT-së, është caktuar zëvendësues i Drejtorit të Drejtoratit të Teknologjisë Informative.
  2. Sipas Vendimit me numër protokolli 01/1938/18 të datës 16.08.2018 të zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kadastrale, nëpunësi K.A nga pozita Ekspert për kadastër është caktuar ushtrues detyre i Drejtorit në Drejtoratin e Regjistrimit mbi Pronat e Paluajtshme.
  3. Sipas Vendimit me numër protokolli 01/3640/20 të datës 01.12.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kadastrale, nëpunësi B.Sh nga pozita Udhëheqës i Sektorit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit është caktuar zëvendësues i Drejtorit në Drejtoratin Ligjor.
  4. Sipas Vendimit me numër protokolli 2131/21 të datës 03.06.2021, të ministrit të MMPHI-së, nëpunësja A.Th nga pozita e Drejtoreshës së Drejtorisë së Teknologjisë Informative është caktuar zëvendësuese e Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë Kadastrale të Kosovës.
  5. Sipas vendimit me numër protokolli 01/3641/20 të datës 01.12.2020 të zëvendësueses së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kadastrale, nëpunësi N.SH nga pozita Zyrtar Ligjor 2 është caktuar në pozitën zëvendësues i Udhëheqësit të Sektorit-Hartimi dhe Harmonizimi i legjislacionit.



## KONSTATIMET:

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të vendimeve në fuqi lidhur me caktimin e zëvendësuesve ka konstatuar së shumica nga pozitat e ushtruara me zëvendësues në këto institucione janë pozita të lira dhe se baza juridike e nxjerrjes së këtyre vendimeve është Ligji Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.

Po ashtu Kolegji ka konstatuar së të gjithë zëvendësuesit realizojnë pagë sipas koeficientit të pozitës që ushtrojnë si zëvendësues.

Ndërlidhur si me lartë, Kolegji nga provat materiale verën se pozita Udhëheqës i Divizionit për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale, është e lirë që nga muaji 9/2019 e cila në vazhdimësi ushtrohet fillimisht me ushtrues detyre e pastaj me zëvendësues, pozita e Drejtorit të Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore është e lirë nga muaji maj 2021 dhe e njëjta ushtrohet me zëvendësues, ndërsa pozita e Udhëheqësit të Divizionit për Kimikate dhe Mbeturina është e lirë nga muaji shtator 2021 dhe ushtrohet me zëvendësues.

Po nga provat e siguruara me rastin e vizitës monitoruese, është konstatuar së sipas Vendimit me numër protokollit 5467/21 të datës 02.12.2021 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, nëpunësi N.A nga pozita e zëvendësuesit të Udhëheqësit të Divizionit për Pagesa Ujore dhe Projekte, është caktuar zëvendësues në pozitën e Drejtorit të Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore, ndërsa sipas Vendimit me numër protokollit 5401-2/19 të datës 18.03.2021 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, nëpunësja V.I nga pozita e ushtruese e detyrës së Udhëheqëses së Divizionit për Mbrojtjen nga ndotja Industriale është caktuar në pozitën zëvendësuese e Udhëheqësit në Divizionin për mbrojtjen nga ndotja industriale dhe rrjedhimisht duke u bazuar në bazën ligjore mbi të cilin është bërë zëvendësimi, nëpunësi civil N.A nuk ka mundur të caktohet si zëvendësues në pozitën e Drejtorit të Autoritetit Rajonal të Pellgjeve pasi që i njëjti nuk është udhëheqës i divizionit apo nëpunës civil profesional në kuadër të Departamentit të Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore.

Kolegji po ashtu gjen se sipas Vendimit me numër protokollit 01/1938/18 të datës 16.08.2018 të U.d Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kadastrale, nëpunësi K.A nga pozita Ekspert për kadastër është caktuar ushtrues detyre i Drejtorit në Drejtoratin e Regjistrimit mbi Pronat e Paluajtshme dhe se i njëjti ende ushtron këtë detyrë, e mbi këtë konstatim rrjedhë se një veprim i tillë i organit të punësimit bie ndesh me nenin 83 paragrafi 10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin shprehimisht është përcaktuar se: *Hyrja në fuqi e këtij ligji përbën shkak ligjor për përfundimin e*



*marrëdhëniet e punës me ushtruesit e përkohshëm të detyrës së zyrtarëve publikë. Ushtruesit e detyrës kthehen në vendin punës.*

Bazuar në dispozitat ligjore të nenit 18 paragrafi 5, nenit 19 paragrafi 4 dhe nenit 20 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, Kolegji vlerëson së këto dispozita ligjore i referohen dhe si të tilla duhet të vijnë në zbatim vetëm në rastet kur pozita e punës është e plotësuar me nëpunës civil mirëpo në raste të caktuara mbajtësi i pozitës përkohësisht nuk mund të ushtroj detyrën si p.sh gjendet në pushim vjetor, pushim mjekësor, vizitë jashtë vendi, apo raste të ngjashme, e në këto raste mbajtësi i pozitës zëvendësohet përkohësisht nga nëpunësi civil sipas kriterëve të përcaktuara me dispozitat e lartcekura ligjore, gjegjësisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore:

- Sekretari i Përgjithshëm/pozita ekuivalente, në rast mungesës zëvendësohet nga drejtori i një prej departamenteve të ministrisë/agjencisë ekzekutive, i caktuar me shkrim nga vetë sekretari i përgjithshëm/pozita ekuivalente. Në rast pamundësie shëndetësore, drejtori i departamentit që zëvendëson sekretarin e përgjithshëm/pozita ekuivalente, caktohet me shkrim nga ministri.
- Drejtori i departamentit në rast të mungesës, zëvendësohet nga udhëheqësi i divizionit, i caktuar me shkrim nga vetë drejtori apo, në rast pamundësie shëndetësore, caktohet me shkrim nga sekretari i përgjithshëm/pozita ekuivalente.
- Udhëheqësi i divizionit në rast të mungesës, zëvendësohet nga nëpunësi civil i nivelit më të lartë i të njëjtit divizion. Në rast se ka më shumë se një nëpunës civil të të njëjtit nivel, ai zëvendësohet nga nëpunësi civil i nivelit më të lartë, që ka përvojë më të gjatë në Shërbimin Civil. Në rast pamundësie shëndetësore të udhëheqësit të divizionit, zëvendësimi caktohet nga drejtori i departamentit.

Andaj, meqenëse shumica e pozitave të punës në MMPHI dhe Agjencinë Kadastrale të Kosovës kanë qenë pozita të lira, Këshilli konstaton se MMPHI dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës gabimisht ka zbatuar ligjin material me rastin e plotësimit të pozitave të lira me zëvendësues duke u thirrur në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarur, sepse siç u konstatua me lartë zëvendësimi sipas këtyre dispozitave ligjore nuk i referohet plotësimit të pozitave të lira, por vetëm pozitave të cilat janë të plotësuara mirëpo që nëpunësi civil për shkaqe të cekura si me larte, përkohësisht nuk mund të ushtroj detyrën e tij.

Ndërsa, plotësimi i pozitave të lira sipas vlerësimit të Kolegjit, duhet të bëhet si në vijim:

- **pozitë e kategorisë profesionale:** një pozitë profesionale e lirë fillimisht plotësohet përmes procedurës së lëvizje brenda kategorisë së njëjtë, sipas nenit 38 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, e në rast së plotësimi nuk mund të behët sipas kësaj procedure atëherë plotësimi i pozitës behet në pajtim me dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Mirëpo, nëse konsiderohet e nevojshme, deri në plotësimin e pozitës së lirë, organi i punësimit mund të zbatoj procedurat e transferimit të përkohshëm sipas nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

- **pozitë e kategorisë së mesëm dhe të ulët drejtuese:** një pozitë e lirë e kësaj kategorie fillimisht plotësohet përmes procedurës së lëvizje brenda kategorisë së njëjtë, sipas nenit 38 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, e në rast së plotësimi nuk mund të behët sipas kësaj procedure atëherë plotësimi i pozitës behet përmes procedurës së ngritjes në detyrë, sipas nenit 39 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Po ashtu, edhe në këtë rast, nëse konsiderohet e nevojshme, deri në plotësimin e pozitës së lirë, organi i punësimit mund të zbatoj procedurat e transferimit të përkohshëm sipas nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

-**pozitë e nivelit të lartë drejtues:** në kuptim të dispozitave të nenit 42 paragrafi 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 6 paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores (QRK)–Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues (*tani e ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr.01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues*) proceduara e konkurrimit duhet të iniciohet tre (3) muaj para së një pozitë të behët e lirë, e në qofte se përzgjedhja e zyrtarit të lartë drejtues dështon edhe në procedurën e dytë atëherë deri në plotësimin e pozitës, detyra ushtrohet nga nëpunësi i kategorisë së mesme drejtuese me përvojë më të gjatë në Shërbimin Civil të institucionit siç është paraparë me nenin 40 paragrafi 11 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ndërsa, përkitazi me rastin ku për çfarëdo arsye gjatë mandatit të rregullt një pozitë e nivelit të lartë drejtues behët e lirë p.sh. vdekja e zyrtarit të lartë, heqja dorë nga shërbimi civil, përfundimi i marrëdhënies së punës etj, pozita në fjalë mund të zëvendësohet përkohësisht vetëm përmes transferimit të përkohshëm sipas nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji vlerëson se zbatimi i dispozitave të nenit 32 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë vije në shprehje në rastet e mungesës së përkohshme të një nëpunësi civil të rregullt, për një




periudhë jo më të gjatë se 12 (dymbëdhjetë) muajsh, p.sh zëvendësimi i nëpunësit civil që gjendet në pushim të lehonisë, pushim pa pagesë, shkaqe shëndetësorë etj. Zëvendësimi në rastet e tilla duhet të bëhet vetëm përmes zbatimit të procedurës së pranimit sipas nenit 80 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

## REKOMANDIM:

Nisur nga të gjetura dhe konstatimet si me sipër, Kolegji rekomandon Ministrin e MMPHI-së, Sekretarin e Përgjithshëm dhe Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të MMPHI-së si dhe Drejtorin e Përgjithshëm dhe Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, që t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për eliminimin e shkeljeve të konstatuara sipas këtij raporti, në mënyrë që plotësimi i pozitave të lira të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

**Ardita Haxhnikaj-Demi**

  
Kryetare e Kolegjit



**Ardita Perçuku Shyti**

  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

### Raporti i dërgohet:

- Përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës ncia Kadastrale e Kosovës;
- Ministrin të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Sekretarin të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Drejtorin të Përgjithshëm në Agjencinë Kadastrale të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kadastrale të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK.

